



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. APK-DPKI-06-1727/24, për zyrtarin e lartë publik z. Endrit Gllareva, Drejtor i Drejtoratit për Infrastrukturë Lokale- Komuna e Glllogocit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Endrit Gllareva, Drejtor i Drejtoratit për Infrastrukturë Lokale ne Komunën e Glllogocit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/1-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): “ z. Endrit Gllareva ka pasur një biznes privat, një zyre projektimi të regjistruar me emrin “Gllareva Projekt SH.P.K”. Edhe pse aktualisht figuron që emri i tij është larguar nga regjistri i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), si pronar apo përfaqësues ligjor i kësaj kompanie, emali personal i tij ende figuron si informacion kontaktues në regjistrin e ARBK-së. Ky fakt tregon se lidhjet e tij me këtë kompani mund të mos jenë ndërprerë plotësisht, por vetëm e ka tërhequr emrin e tij nga pronari, duke bartur tek familjaret e tije, me ç’ rast duke përdorur pozitën të cilën e mban në Komunën e Glllogocit, si Drejtor i Urbanizmit, i “obligon” kompanitë që pajisja me leje të jetë e aprovuar, ajo të projektohet nga kompania “Gllareva Projekt SH.P.K [...]”.

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencin për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1727/24, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Endrit Gllareva, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimit të ngritur nga raportuesi i rastit për zyrtarin e lartë publik z. Endrit Gllareva, Drejtor i Drejtoratit për Infrastrukturë Lokale në Komunën e Glllogocit, është organizuar dhe mbajtura një takim me zyrtarin në fjalë, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit të ngritura për konflikt të interesit.

Në takim, zyrtari i lartë publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë duke theksuar se: *“ Pronar i zyrës projektues “Gllareva Projekt SH.P.K. ”, është vëllau ime, meqenëse me profesion jam arkitekt aty kom punuar si punëtor, nuk kam qenë pronar, e as përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë. Në vitin 2018, është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës, dhe janë ndarë dy Drejtorate dhe atë Drejtorati i Infrastrukturës Lokale dhe Drejtorati për Zhvillim Ekonomi. Kështu që Drejtorati për Infrastrukturë Lokale ku jam Drejtor nuk lëshon leje ndërtimore, por Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit. Drejtorati i Infrastrukturës Lokale, bën menaxhimin dhe mbikëqyrjen e investimeve kapitale në Komunë, e jo për në sektor privat”.*

Nga informatat që përmban raportimi për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur me zyrtarin Endrit Gllareva, si dhe informacioni/ dokumentacioni në dispozicion (*Ndryshim dhe Plotësimi i Statutit të Komunës së Glllogocit i dt. 29.03.2018, Vendimin nr. 01-101/03-62362, i datës 03.12.2021, i Kryetarit të Komunës mbi emërimin e z. Gllareva Drejtor i Drejtoratit për Infrastrukturë Lokale*), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit*, për zyrtarin e lartë z. Endrit Gllareva, përkitazi me pretendimin e ngritura nga raportuesi i rastit se duke përdorur pozitën si drejtor i urbanizimit i obligon kompanitë që pajisja me leje të jetë e aprovuar, ajo duhet të projektohet nga kompania *“Gllareva Projekt Sh.P.K, për faktin se zyrtari i lartë z. Gllareva është Drejtor i Drejtoratit për Infrastrukturë Lokale, ndërsa bazuar në Ndryshim dhe Plotësimi i Statutit të Komunës së Glllogocit të datës 29.03.2018, përgjegjës për lëshimin e lejeve ndërtimore është Drejtorati për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit.*

Kësisoj me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

“Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”

Pra në kuptim të dispozitës së sipërcituar, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jetë plotësuar njëri nga kushtet kumulative, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes në çështjen konkrete.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në rastin konkret, nuk ka gjetur që në kuptim të dispozitës së cekur më lartë, zyrtari i lartë z. Gllareva të ketë qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit, sa i përket lidhshmërisë së drejtorit z. Endrit Gllareva dhe kompanisë projektuese "Gllarvea Projekt sh.p.k.", bazuar në informatat e biznesit të kompanisë të sipërpërmendur të marruar nga ARBK, rezulton që z. Gllareva nuk është pronar, drejtor i përgjithshëm dhe/apo përfaqësues i autorizuar i biznesit në fjalë, gjendje kjo e cila nuk e ve në ndonjë kufizim apo papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa, lidhur me pretendimet tjera të raportuesit të rastit të cilat janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe rrjedhimisht jashtë kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk janë trajtuar gjatë kësaj procedure .

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


YR/BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit